



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.170.dt.31.08.2000

**PER
MIRATIMIN E DALJES JASHTË PËRDORIMIT TE AUTOBUZIT TE
SHKOLLES "LORO BORICI"**

Këshilli Bashkiak i Tiranës i mbledhur sot më dt.31.08.2000 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e kulturës dhe Arsimit "Për miratimin e daljes jashtë përdorimit të autobusit të shkollës "Loro Boriçi", mbështetur në ligjin 7572 dt.10.06.1992 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal në republikën e Shqipërisë" VKM Nr.170 dt.03.04.1993 "Për disa ndryshime të VKM-së Nr.70 dt.11.03.1985 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave monetare si dhe akteve të tjera nënligjore me zbatim të tyre

V E N D O S I

1. Të miratojë daljen jashtë përdorimit të autobusit të shkollës "Loro Boriçi"
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e kulturës e arsimit dhe drejtoria e shkollës "Loro Boriçi"
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI
ORHAN SAKIQI

